

Бр./Nr. 10-1327/7
15-6-2026 год./viti
СКОПЈЕ - ШКУП

Në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 3, nenit 8 paragrafi 1 alineja 6, nenit 8-a paragrafi 1 alineja 2, nenëve 8-b dhe 8-v të Ligjit për Byronë e Zhvillimit të Arsimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13, 41/14, 30/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 74/25), nenit 26 dhe nenit 27 paragrafi 4 të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 161/19), nenit 2 të Rregullores për formularin e aplikimit për pjesëmarrje në thirrje publike për përzgjedhje dhe akreditim të programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për zhvillim profesional të kuadrit edukativo-arsimor në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 96/21), Planit Vjetor të Punës së Byrosë për vitin 2026 nr. 01-160/2 të datë 27.01.2026, Programit për trajnim dhe aftësim profesional të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2026 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 29/26 më 12.02.2026), të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, nenit 2 paragrafi 1 pika 2 dhe paragrafi 2, si dhe nenit 3 të Rregullores për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për zhvillim profesional të kuadrit edukativo-arsimor (mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë) në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut nr. 01-333/5 më datë 22.04.2025, Byroja e Zhvillimit të Arsimit shpall:

KONKURS PUBLIK

për përzgjedhjen dhe akreditimin e programit me përparësi të trajnimit dhe ofruesit të shërbimeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve lëndorë në shkollat fillore

Byroja e Zhvillimit të Arsimit shpall konkurs publik për akreditimin e programit me përparësi të trajnimit dhe ofruesit të shërbimeve për aftësim profesional të mësimdhënësve lëndorë në shkollat fillore me temë:

“Zbatimi i mjeteve digjitale për mësimdhënie interaktive”

Ofruesit e interesuar duhet të përgatisin dhe dorëzojnë program për realizimin e trajnimit në kohëzgjatje prej 8 orësh, të organizuar në një ditë ose në dy ditë nga 4 orë, i cili do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit.

Kushtet për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes dhe akreditimit të programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve lëndorë në shkollat fillore, kërkohet plotësimi i kritereve të mëposhtme dhe dorëzimi i dokumenteve:

1. Dokument për veprimtari të regjistruar i lëshuar nga Regjistri Qendror i RMV-së;
2. Gjendja aktuale e lëshuar nga Regjistri Qendror;
3. Bilanci i gjendjes dhe bilanci i suksesit i lëshuar nga Regjistri qendror;
4. Vërtetim se nuk është hapur procedurë falimentimi;
5. Vërtetim se nuk është hapur procedurë likuidimi;
6. Vërtetim për tatime, kontribute dhe detyrime publike të paguara, i lëshuar nga Drejtoria e të Ardhurave Publike;

7. Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për personat juridikë se nuk i është shqiptuar ndalim i përkohshëm ose i përhershëm për ushtrimin e veprimtarisë;
8. Vërtetim se me vendim të formës së prerë nuk i është shqiptuar ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
9. Vërtetim se nuk i është shqiptuar ndalim për pjesëmarrje në procedura të thirrjeve publike, prokurimeve publike ose partneriteteve publiko-private;
10. Deklaratë për përvojë në realizimin e trajnimeve për zhvillim profesional, me dëshmi se në pesë vitet e fundit janë realizuar të paktën tre trajnime për mësimdhënës/bashkëpunëtorë profesionalë në arsimin formal;
11. Deklaratë se ofruesi do të sigurojë hapësira adekuate për mbajtjen e trajnimeve për grupe deri në 25 pjesëmarrës, me sallë të pajisur me projektor, kompjuter, pajisje audio, internet dhe ambiente sanitare. Nëse trajnimi realizohet në një ditë (8 orë), sigurohen ushqim, kafe dhe pije joalkoolike; nëse realizohet në dy ditë nga 4 orë, sigurohet vetëm freskim;
12. Listë dhe biografi (CV) e së paku 40 trajnerëve në nivel shtetëror për fushën përkatëse, të cilët:
 - të kenë së paku shkallën VII/1 të arsimit, përkatësisht 240 kredi, gjë që dëshmohet me dorëzimin e një kopjeje të diplomës ose certifikatës për përfundimin e arsimit, dhe të kenë realizuar të paktën 2 (dy) trajnime në fushën përkatëse, gjë që dëshmohet me dorëzimin e një vërtetimi origjinal ose rekomandimi për trajnimet e realizuara, të lëshuar nga institucioni/kompania për të cilën është kryer shërbimi, ose
 - janë ligjërues në të paktën një (1) program studimor në fushën përkatëse, gjë që dëshmohet me dorëzimin e një vërtetimi origjinal të lëshuar nga institucioni për të cilin kryhet shërbimi, përkatësisht institucioni ku janë të punësuar dhe/ose të angazhuar.
13. Deklarata nga trajnerët se pajtohen të realizojnë trajnimet konkrete.

Me dokumentin nga pika 1 dëshmohet se ofruesi është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë të paktën pesë vjet para datës së shpalljes së thirrjes.

Me dokumentin nga pika 3 dëshmohet se ofruesi ka të ardhura minimale totale prej 6.000.000 denarësh gjatë tre viteve të fundit.

Kriteret e mësipërme janë eliminuese.

Personi zyrtar i autorizuar nga Byroja, i cili e udhëheq procedurën, është i detyruar që brenda tre ditëve nga dita e pranimin të aplikimit për pjesëmarrje nga ofruesi i interesuar, sipas detyrës zyrtare, t'i kërkojë dokumentet nga pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 nga organi kompetent.

Dokumentet nga pikat 10, 11, 12 dhe 13 përgatiten, nënshkruhen, vulosen dhe dorëzohen nga personi përgjegjës i ofruesit.

Ofruesi duhet të dorëzojë një program për akreditim në temën konkrete të shpallur në thirrjen publike, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e thirrjes publike.

Ofruesi duhet të dorëzojë edhe ofertën me çmimin për pjesëmarrës, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e thirrjes publike.

Kriteret për vlerësimin e ofertave të pranuar janë:

- çmimi për pjesëmarrës (mësimdhënës) – 30 pikë;-
- përmbajtja e programit të ofruar – 60 pikë;
- monitorimi i efekteve të trajnimit – 10 pikë.

Trajnimet për mësimdhënësit lëndor në shkollat fillore do të realizohen në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Nëse formohet grup pjesëmarrësish që ndjekin mësimin në gjuhën turke, ofruesi është i detyruar të sigurojë përkthim konsektiv në gjuhën turke.

Trajnimet duhet të realizohen në grupe me maksimum 30 pjesëmarrës, përmes aktiviteteve të bazuara në metoda interaktive dhe të nxënit përmes përvojës.

Mjetet financiare për realizimin e trajnimit sigurohen përmes Projektit për Përmirësimin e Arsimit Fillor, të mbështetur nga Banka Botërore.

Realizimi i trajnimeve do të fillojë gjatë vitit 2026, sipas dinamikës së përcaktuar në kontratën me ofruesin e përzgjedhur.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit nxjerr Vendim për akreditimin e programit dhe ofruesit të shërbimeve me vlefshmëri prej tre (3) vitesh dhe lidh kontratë me ofruesin e zgjedhur për realizimin e trajnimeve.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit nënshkruan kontratë me ofruesin e përzgjedhur për realizimin e trajnimit. Në kontratë përcaktohet në mënyrë të qartë afati kohor, fazat dhe dinamika e zhvillimit të trajnimit.

Thirrja publike zgjat 20 ditë, pa përfshirë ditën e publikimit.

Hapja publike e ofertave do të mbahet më **06.07.2026 në ora 11:00**, në ambientet e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, rr. "Rugjer Boshkoviç" nr. 20, Shkup.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit në arkivin e Byrosë është **06.07.2026 deri në orën 10:30**.

Aplikimet me dokumentacion të paplotë, të pavlefshëm ose të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Dokumentacioni i nevojshëm mund të merret në arkivin e Byrosë ose nga faqja e saj e internetit: www.bro.gov.mk

Në hapjen publike të ofertave mund të marrin pjesë personat përgjegjës të ofruesve të paraqitur ose përfaqësuesit e tyre me autorizim me shkrim të nënshkruar dhe vulosur.

Si ofrues të programeve të trajnimit dhe shërbimeve për zhvillim profesional mund të paraqiten institucione publike dhe private, shoqata qytetare dhe shoqata tregtare.

Ofruesit mund të paraqiten individualisht ose të bashkohen në grup ofruesish për të dorëzuar aplikim ose ofertë të përbashkët.

Në këtë konkurs nuk mund të paraqiten si ofrues ose trajnerë të angazhuar personat e punësuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byronë e Zhvillimit të Arsimit, Qendrën Shtetërore të Provimeve, Qendrën për Arsimin e të Rriturve, Qendrën për Zhvillimin e Arsimit Profesional, Inspektoratin Shtetëror të Arsimit dhe drejtorët e shkollave.

Pyetjet lidhur me këtë thirrje mund të dërgohen në formë elektronike jo më vonë se 3 ditë para hapjes publike të ofertave në adresën elektronike: bro.macedonia@bro.gov.mk, me shënimin: „Për Komisionin për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për kuadrin edukativo-arsimor – mësimdhënësit lëndorë në shkollat fillore”.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit